



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 45 prot.

Kamëz, më 22.04.2024

V E N D I M
Nr. 38 .Datë 22/04 2024
M B I

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR DJEGIE BANESE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.04.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.31 Datë 17.04.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.275, datë 21.03.2024, për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesë, relacionit të hartuar nga administrata e Bashkisë, në zbatim të urdhërit, dhe V.K.B. Kamëz Nr. 103, datë 18.12.2023 “Për miratimin e detajuar të buxhetit për vitin 2024 dhe planit të buxhetit për vitet 2024 ; 2025, dhe 2026, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për djegie banese të z. Shkëlqim Kamber Leka, për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 17.03.2024.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko – ligjorë hartuar në formën e kritereve në relacion, sipas preventivave të komisionit të vlerësimit të dëmeve hartuar nga administrata e Bashkisë Kamëz, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmtimeve të shkaktuar në banesën e z. ”.
3. Të akordohet një ndihmë financiare për këtë familje sipas tabelës më poshtë:

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Vlera e dëmit lekë	Për pagesë, 50% e vlerës në lekë, sipas VKM-së nr. 329, dt. 16.05.2012
1		463,782	231,891
	TOTALI	463,782	231,891

4. Ndihma financiare për familjen e dëmtuar përcaktohet sipas kritereve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

5. Kjo shumë prej 231,891 (dyqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një) lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI